



Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr. 060-795 2018

Klinë, 18. 12. 2018

## EKSTRAT-PROCESVERBAL

**Nga Takimi i II-të i Kryetarit të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, me Qytetarë, mbajtur me datë 18. 12. 2018 në orën 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

Kryetari i Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, pasi përshëndeti qytetarët e pranishëm në takim, nënkryetarin e Komunës, drejtorin e DKRS, Skender Merturi, ai, informoi se Drejtorët e tjerët janë në aktivitete të tjera, si Komiteti për Politikë dhe Financa dhe takime të tjera pune, prandaj mungojnë me arsye në këtë takim. Përshëndeti gjithashtu përfaqësuesit e KFOR-it, mediat, etj.

“Mirë se keni ardhur në këtë takim të dytë me qytetarë, takim të cilin e kemi obligativ.”-theksoi kryetari Elezaj, në vazhdim të fjalës dhe në pika të shkurtra informoi qytetarët për punën e ekzekutivit, projektet e realizuara dhe ato që priten të realizohen.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** “Qëllimi i jonë si ekzekutiv ka qenë që komplet buxhetin e planifikuar ta implementojmë me sukses duke realizuar projekte në të mirë të qytetarëve. Mund të konstatoj se me sukses kemi arrit që të përgatisim procedurat e tenderimit, të shpallim dhe të lidhim kontratat për të gjitha projektet që kanë qenë të parashikuara për këtë vit. Gjithsej kemi 3 milion e 368 mij e 285 euro kontrata në investime kapitale për këtë vit. Mund të them se jam i kënaqur por ka pas edhe mangësi, sigurisht që jam i gatshëm të marr edhe përgjegjësitë për mangësitë që kemi pasur.” – theksoi kryetari Elezaj.

Në vazhdim të prezantimit të punës së ekzekutivit, kryetari Elezaj u ndal tek disa projekte më specifike të realizuara gjatë këtij viti ku kryetari nuk ishte i kënaqur me punën e bërë. “Më lejoni të përmend disa projekte specifike, si kanalizimi në Zajm, varrezat e Dëshmorëve, një projekt tjetër në Gremnik, pra janë tri projekte që neve na kanë vënë në dilemë dhe kemi shqyrtuar mundësinë e ndërprerjes së kontratës. Por shkak i kohës së procedurave të reja etj, kemi vendosë që të bëjmë presion në përmirësimin e kualitetit të punës. Edhe pse janë afër përfundimit të punëve, ne nuk jemi aspak të kënaqur. Gjithashtu, një projekt tjetër që na ka krijuar pakënaqësi neve si ekzekutiv është edhe furnizimi me zhavorr-pjesa e dytë. Pjesën e parë e kemi përfunduar me sukses por në pjesën e dytë ka ngecë puna dhe ne kemi filluar me procedurat e shkëputjes së kontratës me kompaninë që ka qenë e kontraktuar. Buxheti i këtij viti ka qenë buxhet i aprovuar nga qeverisja e kaluar. Ne jemi munduar me përpikëri ta realizojmë. Duke qenë

të përhershëm në teren, kemi biseduar me qytetarë pa dallim përkatësie partiake dhe jemi munduar që t'ju shërbejmë të gjithëve njëllë. Gjatë takimeve të tilla, kanë ardhur kërkesa specifike nga qytetarët, i kemi shqyrtuar me seriozitet të gjitha dhe besoi që aty ku është realizuar një projekt, qytetarët janë të kënaqur. Është fundi i vitit, kemi arritur që të i kryejmë pothuajse të gjitha procedurat e pranimeve teknike të projekteve të realizuara por janë edhe disa projekte që janë në implementim e sipër. Pra, puna vazhdon edhe në këto ditë të fund vitit, kompanitë e kontraktuara janë të angazhuara që ti kryejnë obligimet e tyre kontraktuese. Fatbardhësisht temperaturat janë mbi zero, prandaj edhe në këto momente që po flasim, në rrugët e përgatitura po shtrohet asfalt, si në Gllarevë, Qabic, në lagjen "Grykaj". Janë edhe disa rrugë pa përfunduar por që zotimet e kompanive janë se do të kryhen. Është një specifikë këtu që duhet theksuar. Shtresa e fundit e asfaltit, kap 70% të vlerës totale, prandaj nëse ne nuk arrijmë me e përfunduar në total edhe me shtresën që kap koston më të madhe, atëherë ato mjete kthehen mbrapa. Pra kjo është një sfidë, të cilën jemi të mobilizuar që ta realizojmë dhe besoi që deri me datë 25 dhjetor, kur është edhe afati i fundit i pagesave do ti realizojmë në plotësi të gjitha këto projekte." Theksoi kryetari Elezaj, duke vazhduar tutje me kronologjinë e aktiviteteve të tjera e që për kryetarin Elezaj, janë dy sfida të tjera mjaft të rëndësishme, ajo e furnizimit me ujë të pijes dhe trajtimin e ujërave të zeza. " Këto sfida vazhdojnë të jenë vërtetë sfida, por angazhimi i ynë ka qenë maksimal. Në këtë drejtim, ne kemi arritur që ta vejmë në funksionin rrjetin e ujit të pijes në fshatrat Sferkë, Dush, Volljak, Qupevë, me gjithë problemet e rrjetit të vjetruar. Përshtypjet e qytetarëve janë se furnizimi në këto fshatra është në rregull. Gjithashtu me Kompaninë "Hidrodrini" kemi pasur takime të vazhdueshme dhe janë bërë përmirësime të dukshme. Janë ndërruar pompat në Jarinë dhe po vazhdon të bëhet ndërrimi i pompave dhe edhe pse ka përmirësime, përsëri nuk është ajo zgjidhja që unë e dëshiroj për qytetarët e Komunës së Klinës. Pra, ne po vazhdojmë të furnizohemi me ujë nga fabrika e pastrimit të ujit, e cila ka kapacitete të mëdha porse nuk i arrin ato kapacitete. Ajo prodhon vetëm 30 L/s. Kjo është situatë që e kemi dhe nuk mund të bëjmë diçka tjetër më shpejt. Angazhimet e mija përgjatë tërë vitit kanë vazhduar duke kontaktuar me Istogun që të furnizohemi nga Istogu por ende nuk kemi përgjigje nga andej. Këto ditë do të kërkoj një takim me kryeministrin dhe kryetarin e Istogut për këtë qëllim dhe në qoftë se nuk arrijmë marrëveshje atëherë duhet të punojmë në një alternativë tjetër. Është një projekt ideor që e kemi përgatitë. Do të kërkojmë zgjerimin e liqenit akumulues te fabrika-Ndërtimin e një liqeni që do të ishte edhe rekreativ dhe që do të ngritë nivelin e ujit nëntokësor si dhe ndërtimin e puseve të mjaftueshme të shoqëruara me drenim profesional dhe në këtë mënyrë të bartet deri tek fabrika. Sipas analizave, uji i "Drinit të Bardhë" Nuk ka nevojë për trajtim me preparate kimike. Kjo nënkupton që nuk ka nevojë me e largu asnjë element kimik me procesim por vetëm ka nevojë për trajtim biologjik. Kosto e këtij projekti duke përfshi edhe rritjen e kapaciteteve të fabrikës është planifikuar të jetë deri në dy milion euro( 1.2 milion për ndërtimin e liqenit akumulues dhe rreth 800.000 për zgjerimin e kapaciteteve teknologjike të fabrikës) Për këtë projekt, ne, kemi kërkuar një amendamentin të buxhetit dhe shpresojmë në mbështetjen e qeverisë. Ky pra, është projekti ideor që ne e kemi menduar nëse nuk arrijmë të kemi marrëveshje me Komunën e Istogut." – theksoi kryetari Elezaj në fjalën e tij, duke u ndalur gjithashtu edhe tek punët e kryera dhe projektet e planifikuara për ujërat e zeza. Ai në lidhje me këtë çështje theksoi: " Jemi duke punuar vazhdimi. Kemi kontakte me qeverinë Austriake dhe me Bankën Evropiane për zhvillim. Kemi dërguar projekte në BEZH por nuk kemi përgjigje akoma. Ndërsa me Austriakët jemi në fazën intezive dhe ata na kanë ofruar një grand diku te 100.000 euro për studim, ndërsa ne duhet të participojmë me 20%. Këto ditë jemi duke kërkuar pëlqimin nga Ministria e Financave. Një studim i tillë i fizibilitetit është i nevojshëm dhe nga fillimi i vitit do të realizohet. Gjithashtu edhe organizata CDI e cila ka investuar edhe në të kaluarën, përsëri do të

investoj dhe atë në vlerë prej 700.000 euro, në sistemin e ujit të pijes. Këto investime do të shkojnë në fshatrat, Gllarevë, Përqevë, Rigjevë, Stapanicë, Gjurgjevik i Madh, Dobërdol, Cerovikë, Çabiq dhe Stupë. E kam menduar Stupën sepse ata kërkojnë "Burimin e Ujit" dhe burimi i ujit për Stupën është nga Peja. Projekti është duke u hartuar dhe vitin e ardhshëm do të fillon të realizohet. Në të njëjtën kohë do të bëhet edhe ndërrimi i gypave të vjetruar, orët e ujit për lagjen Përlina, etj. Me "Hidrodrinin", në Qendër, e kemi një projekt, e që ka qenë edhe kërkesë e qytetarëve. Fjala është për rregullimin e kanalizimit të ujërave të zeza nga sheshi "Nënë Tereza" deri tek hekurudha, ngase ujërat atmosferike po përzihen me ujërat e zeza. Kompania "Hidrodrini" e ka marr përsipër financimin e këtij projekti dhe janë në fazën e tenderimit. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse nuk e kemi përfunduar shtrimin e shtresës së fundit të asfaltit nëpër këto rrugë të Qendrës. Për ujërat e zeza jemi në dy procesime, në dy fshatra, donatori është Francez, ata i kanë përzgjedhë vet. Kam kërkuar që të përfshihet edhe Ujmiri dhe jemi në fazën e implementimit." -përfundon fjalën kryetari Elezaj, duke i falënderuar për pjesëmarrje dhe duke i ftuar që të bashkëbisedojnë në vazhdim të takimit.

**Dukagjini Gashi, Dobërdol:** Përshëndetje kryetar, përshëndetje nënkryetar, përshëndetje drejtorë, përshëndetje të gjithë të pranishëm. Jam Dukagjin Gashi prej Doberdoli, ndoshta jam pak jashtë prej teme, por e kemi problem kyçjen në autostradë. Ju kemi drejtuar një kërkesë juve, e di që nuk është në kompetencën e juaj, por kur ishte dëgjimi për shpronësimin e pronave, kontaktova me një përfaqësues të Ministrisë dhe ai më tha se në javën e fundit është finalizimi i projektit. Kërkoj nga Ju, në emër të 10-të fshatrave, me mbi 800 nënshkrime, që të na përkrahni me Ministrinë e Infrastrukturës, që të bëhet hyrja dhe dalja -rrethi në rrugën "Rigjevë-Ujmir" të udhëkryqi i Zabërgjes. Kur fola me zonjën nga Ministria, i tregova se kemi problem dhe detyrohemi të marrim masa tjera, protesta apo çfarë do që është e nevojshme. Të gjithë ata që janë nënshkruar, janë të gatshëm për bllokimin e vendit, sepse aty ku del rrethi në Rigjevë, mes Rigjevës dhe Stapanicës, është në favor vetëm të 20-të shtëpive. Kërkojmë, në emër të 10-të fshatrave të na ndihmoni dhe të bëhet kyçja aty ku e kemi parashtruar në kërkesë. Kërkesa tjetër është për vitin e ardhëm. Kemi problem me ujëra të zeza, kanalizimin ku e ka lënë pushteti i kaluar. Nëse ka mundësi të na ndihmoni duke e lidhur me Ujmir, kanalizimin, dhe kështu e shpëtoni fshatin tim.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Faleminderit Dukagjin. Për Autostradë, ju kërkesën e keni bërë. Unë e kam iniciuar këtë çështje por do ta kem edhe një takim tjetër. Sa i përket ujërave të zeza, unë e kam dhënë idenë që të kemi një impiant në Shtaricë. Pra ka qenë ide e imja, por akoma nuk e kemi konfirmimin për pranimin të këtij projekti. Nëse realizohet, atëherë në këtë projekt do të përfshihen edhe ujërat e Çabiqit dhe edhe të Dobërdolit.

**z. Ahmet Bajqinovci, lagja mbi stacion:** Përshëndetje kryetar. Ne kemi shprehë shqetësimin për vështirësitë që po na i krijon mos shtrimi të paktën më zhavorr të rrugës sonë, mbi stacion. Kemi biseduar bashkë dhe na keni premtuar që në shkurt do të realizohet, por akoma nuk u rregullua. Shpresoi që të bëhet e mundshme.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Të nderuar. E theksova që në fillim se në projektet problematike është kjo e shtrimit me zhavorr. Besoni që në lidhje me shtrimin e rrugëve me zhavorr, jam shumë i sigurt se kemi lënë shumë mangësi. As në rrugën time nuk kam shtruar asnjë lopatë zhavorr. Ne, duhet ta përfundojmë projektin e shtrimit me zhavorr, këtë vit, dhe në ditët e para të vitit të ri të hapim procedura të reja për furnizim me zhavorr. Shumica e rrugëve janë shtruar me asfalt, ndërsa ato rrugë që nuk janë në planifikim buxhetor për 2019 të shtrohen me asfalt, ato do të shtrohen me zhavorr

gjithsesi. Muaji janar do të na kaloj me procedura dhe në shkurt mbetet të fillohet me punë në këtë drejtim.

**z. Hamit Desku, lagja "Arbëria":** Përshëndetje kryetar. Në lagjen tonë është bllokuar kanalizimi i ujërave të zeza. Sot ishte edhe drejtori i Shërbimeve Publike, z. Ibër Elezaj, dhe e pa gjendjen. Na duhet që të bëhet zhblokimi sepse ujërat e zeza kanë dalë mbi sipërfaqe dhe rrezikojmë të na infektohen bunarët nga ku furnizohemi me ujë të pijes, pasi që ujësjellës nuk ka të instaluar në atë pjesë të lagjes.

**z. Ibër Elezaj, drejtor i SHPEM:** E vërtetë që jemi takuar sot, në lagje. Jemi takuar edhe më përpara bashkë. Aty është fjala për një problem pak më të madh se sa bllokimi. Bllokimi është bërë tek ura e hekurudhës ku më përpara ka kaluar një lumë i vogël. Kjo urë është gati në mbyllje totale nga mbeturinat që banorët i hedhin vazhdimisht. Gypi i kanalizimit është mu në mes të kësaj ure. Ne, biseduam me banorët e lagjes dhe u dakorduam për disa zgjidhje që mbetet të finalizohen. Këtë problem do ta zgjidhim urgjentisht.

**z. Ajet Bajraktari, Jashanicë:** Përshëndetje kryetar, përshëndetje gjithë të pranishmit. Dëshiroi të bëjë një falënderim të veçantë për ty kryetar dhe stafin tuaj për ndihmën që ma keni bërë, meqenëse jam i sëmurë. Dëshiroi një pyetje të bëjë. Rrugën Skënderaj-Klinë, a e mirëmban ndokush sepse kjo rrugë s'ka as vijë të bardhë as pastrim.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Rruga, Skënderaj-Klinë, është në kompetencën e Ministrisë së Infrastrukturës. Është rrugë regjionale dhe është përgjegjësi e MI. Janë në renovim të kësaj rruge aq sa e kam vërejt unë.

**z. Zafer Gashi:** Përshëndetje kryetar. Ju dëshiroi punë të mbarë. Besoi që premtimet e tua gjatë fushatës po vijnë çdo ditë e më shumë në shprehje. Çka është më e rëndësishme, po përmbushën premtimet dhe punët e mira në të mirë të qytetarëve. Krejt kjo falë edhe të një koalicioni të zgjedhur mirë, të cilin shpresoi që nuk harroni ta përmendni më shpesh pasi që ky koalicion është një suport i madh për ju. I nderuar kryetar, është një numër i madh i punëve që i keni kryer dhe po i kryeni. Nuk kam dëshirë që të shoh as xixat më të vogëla të mos suksesit tuaj. Nuk kam dëshirë që të shoh të shkosh rrugës së ish kryetarit, dhe ju nuk po shkoni, por është mirë të jeni më syçelë sepse janë disa drejtori që po vërehet se kanë filluar të mos jenë në nivel. Prej kur drejtorja e Urbanizimit ka të drejt që të jap leje që të kufizohen trotuaret nëpër Klinë? Kanë filluar ndërtimet nëpër trotuare me material të fortë. Kompetencë e cilës drejtori është kjo. Ka vërejtje të shumë qytetarëve, sidomos tek sheshi "Nëna Terezë", ku qytetarët për shkak të bllokimit të trotuareve po detyrohen të ecin në rrugën automobilistike. Shumë projekte të rrugëve që ju i keni iniciuar dhe janë përfunduar, uroi të jenë kryer mirë por qytetarët kanë nga pak vërejtje për punët e kryera. Janë vërejtje të vogëla por që mund të rriten. P.Sh. rruga në Sferkë, është kryer aq bukur por është shumë e ngushtë sa që dy makina nuk mund ti kalojnë përballë njëra-tjetrës. Edhe rruga që ju e keni inspektuar disa herë e që është financuar me fonde të përbashkëta me MI, për të cilën rrugë kam intervenuar tek ju përmes telefonit, pra rruga e Perqevës, ku drejtori i Urbanizimit, i cili ju ka premtuar qytetarëve se do të shkoj që të konsultohet për problemet e kësaj rruge, nuk shkon fare. Janë edhe rrugë të tjera me problem si rruga në Dush, etj. Kam mundur që të them këto fjalë edhe veçantë, pasi që jemi miq të vjetër, por të thuhet publikisht mendoj që është më korrekte. Ndje krenari me punën që bëjnë drejtorët e Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët besoi se nuk e kanë dëgjuar as babën e vet sa ju dëgjojnë Ju.

**z. Zenun Elelaj, kryetar i Komunës:** Faleminderit Zaf. Sa i përket çështjes së parë, trotuareve, me të thënë të vërtetën ka një numër të kërkesave të qytetarëve që kanë biznese përgjatë rrugës kryesore, për zgjerim të hapësirave dhe rrethimin me xhama. Ajo për të cilën po flisni ju, nuk ka leje. Unë vet jam i pakënaqur dhe kam kërkuar që mos i lëshohet leja. Kam kërkuar që t'i jepet një afat i caktuar dhe trotuari të kthehet në destinimin për çfarë është i ndërtuar. Është përgjegjësi e jona, mangësi, kam kërkuar vazhdimisht që ai problem të zgjidhet por nuk mund të justifikohem tani. Gjithsesi që do të rregullohet. Sa i përket rrugës në Sferkë të shkolla, gjerësia e rrugës është çështje e projektit. Aty mendoj që kemi bërë një rrugë të mirë, një trotuar të mirë gjithashtu. Gjerësia prej 4 metrave duke e pasur edhe bankinën anash, besoi që i plotëson kriteret e nevojshme, si rrugë lokale që është. Dhe, e them shumë i bindur se ajo është një nga rrugët më të mira që kemi ndërtuar këtë vit. Për rrugën e Sferkes, jam marrë personalisht vet me të. Shqetësimet që i kanë pasur banorët dhe ju, kam menduar që janë eliminuar, më kanë thënë që janë eliminuar.

**z. Gustin Kabashi, Klinë:** Përshëndetje kryetar. I bashkëngjitëm mendimit të Zaferit sa i përket hapësirave publike, "zaptimit" të tyre, e cila ka ndodhë jo vetëm tek "Albamarket" por edhe në Qendër. Shqetësimi im është se e kam bërë një ankesë para 35 ditëve dhe akoma nuk kam përgjigje. Në kohën kur e kam bërë ankesën, bizneset kanë qenë të pajisura me leje për shfrytëzim të hapësirave publike. Ankesa është e bashkëngjitur me 40 nënshkrime të biznesmenëve që jetojnë dhe punojnë këtu. Mund të them se është bërë një lloj shkelje, injorimi i këtyre nënshkrimeve. E kisha lutë, kryesish Drejtorinë e Shërbimeve Publike, që të merret më shumë me analiza para se të merr vendime. Edhe një herë, në të njëjtën kohë kur ankesa e ime me 40 nënshkrime ka qenë e deponuar në Komune, pa kthyer përgjigje fare, ju ka dhënë leje për shfrytëzimin e hapësirave publike. Unë mendoj që ky objekti i Madh e ka zënë pamjen e Komunës prej qendre, e ka mbyll pamjen e rrethit nga rruga. Por është bërë siç është bërë në kohën kur ju nuk keni qenë në qeverisje. Mos lejoni që të zgjerohet edhe më shumë e mos me pas mundësi njerëzit të lëvizin. Ju lutem që shkelje të tilla si në rastin tim të mos përsëriten. Dhe ju lutem që të merreni më me seriozitet rreth këtyre ndërtimeve sepse nuk është shqetësim vetëm i imi por edhe i 40 qytetarëve-biznesmenëve që më përkrahin dhe i shumë qytetarëve.

**z. Zenun Elelaj, kryetar i Komunës:** Faleminderit Gustin. Ne e kemi biseduar bashkërisht çështjen. Nuk është se ne po tregohemi mospërfillës, por të gjitha ato hapësira publike kanë qenë në shfrytëzim e sipër dhe tani është vështirë më i thënë një biznesi që ta ndërpres at shfrytëzim, derisa ai e ka shfrytëzuar deri tani. Nuk janë ndërtime të forta, janë improvizuese, të rrethuara me vazo lulesh etj. Ka mjaftuar vetëm kornizimi. Kanë vërtetë një leje për shfrytëzim por kurdo që Komuna mendon se duhet tërheq lejen, ato hiqen. Pra kanë leje të përkohshme. Ka qenë një traditë që këtu me u punuar pa leje. Njëri nga ato bizneset e ka qit një reklamë dhe e ka marrë gjobën 50 euro, kur erdhi dhe bëri ankesë e pyeta- a ke pas leje? Dhe ai u përgjigj-Jo. Po mundohemi me i disiplinuar, me mundësi tona. Ndonjëherë edhe personalisht e thërrasinspektoratin për ndërhyrje. Do të përkushtohemi që ti rregullojmë të gjitha çështjet që bien ndesh me ligjin. Unë e di që kërkesën tënde dhe të 40 qytetarëve, është vështirë me marr vendime por prandaj jam këtu për të marr vendime të vështira, pavarësisht nëse i pëlqen apo nuk i pëlqen dikujt, e rëndësishme është të mos merren vendime në dëm të dikujt. Sidoqoftë, ajo është një leje e përkohshme dhe mund të tërhiqet. Unë të inkurajoj që të bisedosh edhe me anëtarët e Kuvendit të Komunës, ata mund ta ngritin si çështje në Kuvend dhe aty të merret vendimi për tërheqje të lejes së shfrytëzimit. Për mua vendimet e Kuvendit janë obligative. E kam shumë më të lehtë të bazohem në atë vendim të Kuvendit dhe të bëjë tërheqjen e lejes.

**z. Gustin Kabashi, Klinë:** Të mos keqkuptohemi. E kam precizuar edhe në ankesë. Nuk jam që të mos ju jepët leje për shfrytëzim të hapësirave publike. Jam kundër përvetësimit të hapësirave publike, ndërtimeve fikse me material të fort, në hapësirat publike. Thjesht, të shfrytëzohet hapësira publike ashtu siç ka qenë më parë e jo sikurse tani.

**z. Lekë Lekaj, Klinë, zona e parë e qytetit:** Përshëndetje kryetar, nënkryetar dhe gjithë të pranishëm. Unë kam kërkesë për lagjen time, është pa infrastrukturë. Unë bashkë me disa banorë kemi biseduar me kryetarin dhe jemi mirënjohës që rruga e lagjes sonë ka me u shtruar asfalt në vitin e ardhshëm. Pyetja e ime është se a është vënë si projekt në realizim. Shqetësim tjetër, rruga që kalon andej është aq e ngushtë sa që jo që nuk i zënë dy makina ballë për ballë por as disa fëmijë dhe një makinë, kështu që, aty tani janë diku 40-50 shtëpi të ndërtuara dhe konsiderohet si lagje. Nuk e di se a është kompetencë e Komunës apo e Ministrisë për zgjerim të rrugës. Problem tjetër është kanalizimi i ujërave të zeza që vjen prej mbi hekurudhës që është kanalizim i ngushtë. Kur ka të reshura atmosferike, ujërat e zeza na futen në shtëpi. A ka mundësi të zgjerimit të atij rrjeti të kanalizimit sepse jemi shumë në hall. Besoi shumë në fjalën e kryetarit se ka me u rregulluar në vitin e ardhshëm rruga por për zgjerim të rrugës nuk e di se kujt duhet me ju drejtuar.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Faleminderit Lekë. Ne kemi biseduar për atë rrugë dhe do të rregullohet vitin e ardhshëm. Ka shumë problem të natyrës së njëjtë, pra zgjerimin e rrugëve dhe pronësia e rrugës. Edhe rruga e sheshit ka problem të njëjta, ka vende të caktuara që është në pronësi të dikujt. Ne kemi ndërmarr, që në seancën e ardhshme do të jetë temë e diskutimit, që kur të bëhet parcializimi i ri, do të kërkojmë që kur ka dy place e më shumë, rruga të kthehet në pronësi publike. Ne do ta ndërtojmë atë rrugë por për çështje pronësore nuk mund të bëjmë asgjë për momentin. Ju duhet të kontaktoni mes vete dhe të vendosni që rrugën ta ktheni në pronësi publike.

**z. Lekë Frroku, përfaqësues i fshatit Dollc:** Përshëndetje kryetar dhe gjithë të pranishëm. Unë i dëgjova qytetarët dhe hallet e tyre, por problemet në Dollc janë shumë më të mëdha se sa ato që i dëgjova këtu. Dollci është para lagje e qytetit të Klinës, por aty s'ka asgjë të mirë. Kemi biseduar me Ju paraprakisht, disa vendime janë marrë por dëshiroi të sigurohem se a do të realizohen. Ka shumë probleme në Dollc, shumë mangësi. Ujësjiellësi nuk funksionon gjatë verës, rrjeti elektrik etj. Jam i rregullt në këto lloj mbledhje dhe dëshiroja që ti keni parasysh këto shqetësime. Uroi që në vitin e ri të realizohen.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Faleminderit Lekë. Të dy projektet janë të parapara për tu realizuar në vitin 2019. Edhe kanalizimi i fshatit Dollc, edhe rruga. Do të kemi problem me kanalizim se ku të bëhet grumbullimi por kur të vijë momenti do ti bisedojmë bashkë detajet, në fillim të këtij vitit që po hyjmë.

**Znj. Lirie Zogaj, Rigjevë:** Përshëndetje kryetar, nënkryetar i Komunës. Ju përgëzoi për të gjitha projektet që i keni realizuar deri me tani dhe ato që keni planifikuar t'i realizoni. Më lejoni që ta ndërroi pak temën. Natyrisht që infrastruktura, mjedisi etj. janë shumë të nevojshme për qytetarin por është edhe shëndetësia. Kam një pyetje, a planifikoni që të funksionalizohen shërbimet shëndetësore nëpër BL? Unë vijë nga Gllareva dhe në mungesë të marrjes së shërbimevëshëndetësore në fshat detyrohemi të bëjmë rrugë të gjatë.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Unë me qellim nuk fola fare për të arriturat e shumta në sektor tjerë përveç asaj në infrastrukturë rrugore. Nuk i përmenda fare përmirësimet e shërbimeve në Shëndetësi, renovimin që është bërë në QKMF, etj. Të gjitha arritjet tona i keni ne web site të Komunës. Sa për informacion, për vitin e ardhshëm janë ndarë 80.000 euro për renovimin e të gjitha ambulancave në BL.

Kemi pak problem me mungesë të kuadrit mjekësor, sidomos me mjek. I kemi tre vende të lira në QKMF për nuk kemi mjek. Kam një lajm të mirë se vitin e ardhshëm do të kemi tre mjek të ri në Komunën tonë , ndërsa lajmi i keq është se posa ti mbushin një vit shërbim në Qendrën tonë , mjekët po ikin në Gjermani dhe në vende të tjera. Pas renovimit të ambienteve në AM në Gllarevë dhe në BL të tjera, ndaj mendimin se do të kemi shërbime më të mira , ashtu siç ka ndodhë edhe në QKMF.

**z. Faton Berisha:** Përshëndetje për të gjithë. Dëshiroi me i diskutuar disa çështje në parim. Ne, si shoqëri jemi të predispozuar që ta pranojmë formën pa përmbajtje. Ju treguat se si është rinovuar QKMF, por a keni ndërmarr masa që të përmirësohen shërbimet. Pra, nëse është bërë investimi që të përmirësohen shërbimet, a janë përmirësuar ato? Problem tjetër është me kompaninë e grumbullimit të mbeturinave. Kompania në fjalë nuk e respekton orarin e grumbullimit, orarin që e ka vendosë vet. Problem është edhe me kompaninë e "Hidrodrinit", ka keqpërdorime të mëdha me ujin. Çfarë masash do të ndërmerrni që kjo dukuri të ndërpritet njëherë e mirë? Tek çështja e ujërave të zeza, ka qenë edhe premtim elektoral i juaj, që do të ndërtoni një impiant për trajtimin e tyre. Ju e përmendet më herët dhe shpresoi që ajo të realizohet. Përndryshe investimet lokale në këtë sferë nuk janë zgjidhje por siç e theksuan edhe shumë qytetarë këtu, ato krijojnë probleme edhe më të mëdha. Çështja e fundit, pa dashur që të marr kohë shumë, nuk po ma lejon background-i profesional pa e përmend, është fjala tek dekorimi i qytetit i cili është shumë i mirëseardhur pasi që jemi në kohë festash, por, vendosja e një pishe në oborr të komunës është veprim jo i duhur, pasi që jep shembull të keq tek qytetarët. Paramendoni se çfarë do të ndodhte sikur çdo familje të dalë e të prej nga një pishë dhe ta vendoste në oborin e vet. Çfarë do të ndodhte me pyjet tona.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Po filloj nga kjo e fundit Faton. Pajtohem me ty por kur e kemi prerë ne Komuna, le te jetë që e kemi prerë për gjithë të tjerët. Megjithëkëtë, pajtohem plotësisht me ty. E kemi diskutuar këtë çështje, nuk e kemi menduar dhe dëshiruar të jetë kaq pishë e madhe por është bërë tashmë dhe është në përgjegjësinë e disa individëve që kanë qenë të angazhuar. Shfrytëzoi rastin që të jap mesazhin për çdo familje, që mos të prenë pemët, le të jetë kjo që e kemi prerë ne për gjithë të tjerët. Sa i përket shërbimeve, unë i inkurajoj qytetarët që të jenë bashkëpunues dhe vërejtjet e tyre t'i dërgojnë tek drejtori i QKMF-së, tek drejtorët e drejtorive por edhe tek unë, natyrisht me emër e mbiemër. Vetëm kështu , ne, mund të përmirësohemi. Impiantin e ujërave të zeza edhe atëherë kur e kam premtuar, e kam dit se do të jetë një sfidë. E kam premtuar që ta realizoi në vitin e tretë të mandatit, dhe të shohim. Nuk është se nuk jemi në hap me kohën, megjithëkëtë, kjo nuk varet e tëra nga unë, varet edhe nga niveli qendror. Në lidhje me grumbullimin e mbeturinave, drejtori i Shërbimeve Publike është këtu por kompania nuk menagjohet nga ne, është në kompetencë të regjionit, porse, ne, me vërejtjet e qytetarëve mund të ndikojmë tek titullari i tyre. Uroi të kem dhënë përgjigjen e duhur.


**z. Mustafë Beqiri:** Përshëndetje bashkëqytetarë. Sot kemi ardh këtu që të njoftohemi me punën dhe angazhimin që e ka bërë kryetari bashkë me strukturat e tij udhëheqëse. Na i dha disa sugjerime, kryetari, se çfarë ka punuar dhe çfarë e ka në plan të punoi, në të ardhmen. Nuk jam as i kushtëzuar e as i obliguar por nga vet dëshira e përcjelli punën e organeve të Komunës, gjegjësisht, edhe të kryetarit, sepse jam qytetarë i kësaj Komune dhe kam dëshirë të dijë se nga shkon populli, dhe në çfarë situatë e gjendje është. Me ju thënë se jam i kënaqur për mandatin e tyre që e kanë pasur gjatë këtij viti, nuk jam krejtësisht, mirëpo, Komuna e Klinës, në katër horizontet e shtrirjes së saj, është prekur me projekte që janë realizuar dhe këta qytetarë të komunës sonë e ndiejnë veten shumë mirë. Sepse ju kanë krijuar mundësitë dhe kushtet që të vazhdojnë jetën pak më me komoditet. Kryetar, unë me të dhënë komplimente për gjëra që nuk janë, nuk mundem, por po ta them se ke kryer një punë të

mrekullueshme, për çka ju nuk e dini por e dimë ne qytetarët sepse janë argumentet, janë faktet që flasin. Prandaj të uroi shumë suksese edhe në të ardhmen dhe të porosis që nga populli mos u ndaj. Për pranimi e qytetarëve në zyrën tuaj, ka shumë fjalë miradije. E ke bërë mikpritjen e qytetarëve në stilin e traditës së odave tona. Kjo është vlerësuar si madhështore. Në emrin tim dhe të qytetarëve që janë prezent, të falënderoj shumë, të jemi mirënjohës dhe të urojmë punë të mbarë.

Kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, në përfundim të takimit falënderoi të gjithë për pjesëmarrje në takim dhe në debat si dhe i siguroi ata se që në ditët e para të janarit do të fillojnë përgatitjet për realizimin e projekteve, sipas buxhetit për vitin 2019. Ai në përmbyllje të takimit theksoi: **"Ashtu siç kam vepruar edhe këtë vit që po e lëmë pas, ashtu do të veproi edhe në vitin e ardhshëm, në kuptimin e konsultimeve me banorët e fshatrave, kryetarët e fshatrave, pavarësisht se çfarë partie politike i takojnë dhe shpresoj se nuk do ti kemi telashet që i kishim këtë vit. Ju uroi festat e fund vitit, urime vitin që po vjen dhe suksese në familje dhe në jetë. Ju faleminderit."** Theksoi në fund të takimit, kryetari Elezaj.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryetari i Komunës:

Zenun Elezaj

